



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:065794

Datë: 11.03.2021

Numri i dokumentit: 01587356

P.nr.1005/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.S. nga Gjilani për shkak të veprës penale vetëgjyqësia nga neni 418 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1725/2018, të datës 05.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 02.03.2021, mori dhe shpalli ndërsa me datë 11.03.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari K.S. nga babai S. dhe nëna R., e lindur I. i lindur me datë ..., në Gjilan ku dhe jeton në lagjen “...”, numër 58, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer fakultetin e psikologjise, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë ....., rreth orës 12:00 h, në rrugën “.....”, në Gjilan me konkretisht në zyrat e gjeodezisë “PRO-GEO”, pas një mosmarrëveshje rreth matjes së një parcele me të dëmtuarin B.S. me ane të përdorimit të forcës dhe kanosjes serioze dhe pa pëlqimin e tij, ka ushtruar një të drejtë që ka menduar se i takon, në vend se ti drejtohet organit kompetent ashtu që i pakënaqur me tretmanin e rastit-matjen, vonesën dhe përgjigjet lidhur me rastin, fillimisht i kërkon parat pastaj i mllëfosur merr instrumentin për matjet gjeodezike dhe largohet nga aty dhe në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e veta ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtën që ka mendur se i takon në vend që ti drejtohet organit kompetent.

-Me çka ka kryer veprën penale vetëgjyqësia nga neni 418 paragrafi 1 i KPRK-ës,

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,46,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 326 e 365 të KPP-ës, të akuzuarin K.S.:

## E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind euro), të cilin dënim i akuzuari i lartcekur obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari Burim Syla për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.11.2018, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1725/18 kundër të akuzuarit K.S. nga Gjiilani, për shkak të veprës penale vetëgjyqësia nga neni 418 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Me datë 02.03.2021, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i akuzuari me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 326 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit dhe rrjedhimisht seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar meqenëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se ky pranim është i mbështetur në provat e tjera materiale bashkangjitur aktit akuzues, fakte këto dhe prova në bazë të të cilave në mënyrë të pa kontestueshme argumentohet fakti se tani i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me ç'rast edhe ka mbetur pranë aktakuzës dhe ka kërkuar nga ana e gjykatës që komfor dispozitave ligjore të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka propozuar gjykatës që t'i merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë e veprës penale.

I akuzuari K.S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se është penduar për veprimet e tij, premtun se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të tilla sepse kjo i ka ndodhur aty për aty pa e menduar mirë dhe e gjitha ka ardhur si pasoje e moskorrektësisë së të dëmtuarit i cili ishte treguar shumë jo korrekt me rastin për të cilin ishin marre vesh për ta kryer dhe se kjo ka ndodhur në kohën kur shitësi i paluajtshmërisë kishte ardhur enkas nga Gjermania për ta bërë bartjen ndërsa i dëmtuari si gjeodet nuk i përgjigjej për punën e tij, kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ka premtuar që në të ardhmen do

te ketë sjellje me te mira dhe nuk do te përsërisë vepra te tilla dhe as vepra te tjera penale gjithashtu ka kërkuar nga ana e gjykatës që t'i shqiptoj një dënim sa më i butë.

## 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kane qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 326 të KPP-ës dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente përkatësisht nuk është kundërshtuar as nga prokurori i shtetit. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tij, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht ky pranimi i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës siç janë: akti përcjellës i datës 29.10.2018, raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2018-CA-1430, i datës 29.10.2018, deklaratat e të dëmtuarit Burim Syla, e dhënë pranë Stacionit Policor në Gjilan, deklaratat e të akuzuarit K.S., e dhënë pranë Stacionit Policor në Gjilan, fotot e aparatit për matje, certifikata mbi dorëzimin e sendit e datës 29.10.2018, informacionet mbi personin, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve, dëftesat mbi konfiskimin e pronës e datës 29.10.2018 raporti i oficerit i datës 29.06.2018 si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari K.S. nga Gjilani, ka kryer veprën penale vetëgjyqësia nga neni 418 paragrafi 1 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, gjykata pati parasysh po ashtu edhe rrethanat personale të kryesit i cili është person familjar, i martuar, baba i një fëmije dhe mbajtës i familjes si dhe sjelljen e tij të mëparshme e cila del të jetë korrekte meqenëse i njejtë më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i njejtë është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, ka kërkuar falje për këto veprime duke shtuar se këto veprime i ka bërë edhe për shkak të mos korrektësisë së të dëmtuarit lidhur me matjen e parcelës për të cilën shitësi kishte ardhur nga Gjermania për ta bërë bartjen, faktin se i

njëti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del i akuzuari këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me gjobë gjykata pati parasysh gjendjen financiare të të akuzuari dhe si rrjedhojë konsideron se me dënim e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të akuzuarit por as familjarëve të tij nuk i cenohet mirëqenia ekonomike gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 76 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 48 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike

Duke pasur parasysh se të dhënat e ofruara nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike gjykata bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, të dëmtuarin B.S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit si dhe bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.1005/2018, me datë 11.03.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të te njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.